



UNIVERSITETI
BARLETI



Universiteti Barleti
Nr. prot. 773 Tiranë 21.07.2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
Nr. prot. 110 Tiranë 17.07.2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET:**

UNIVERSITETIT BARLETI
(Universitet Aplikativ dhe Sipërmarrës)

dhe

NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR ARSIS

duke mbajtur parasysh se:

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të programeve të Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si pjesë të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve nënshkruese, duke përcaktuar detyrimet e përgjithshme të palëve, drejt realizimit në një moment të dytë të marrëveshjeve specifike lidhur me fushat e bashkëpunimit e shkëmbimit të listuara në pikën 2 të këtij neni. Në marrëveshjet specifike do të detajohet lloji i aktiviteteve të përbashkët, si dhe çdo detyrim financiar midis palëve.

2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:
- a. **Fuqizimi i sektorit dhe profesionistëve** në përputhje me standardet, normat dhe direktivat e BE si dhe përmirësime ligjore për mbështetjen dhe mirëfunksionimin e profesionit nëpërmjet përafrimit me nismat dhe iniciativat europiane dhe lobimit për fuqizimin e sektorit dhe profesionit, bashkëpunimeve, rrjetëzimeve dhe partneriteteve për promovim të dyanshëm;
 - b. **Zhvillimit e burimeve njerëzore** përmes edukimit dhe aftësimit drejt kërkesave të tregut të punës e sektorit nëpërmjet bashkëpunimit të të stafit akademik dhe specialistëve të të dy institucioneve, praktikave e punësimit të mundshëm të diplomuarëve, trajnimeve, apo çertifikatave të fushës;
 - c. **Kërkimit të Aplikuar dhe novacionit nëpërmjet** eventeve dhe aktivitete për të promovuar dhe shkëmbyer eksperiencat, organizimit të seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme, konsulencave reciproke, studimeve, etj.
 - d. **Ngritjen dhe realizimin e projekteve dhe programeve nga fonde dhe donatorë të ndryshëm;**

Neni 2

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 5 vjet nga data e nënshkrimit.
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje do të konsiderohet e rinovuar.

Neni 3

Informacion mbi palët

1. *Universiteti BARLETI* (në vijim Barleti) është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkurruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni



akademik elitar, bazuar në praktikat e vlerat më të mira ndërkombëtare, më programe shumë-disiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. Nisma Për Ndryshim Shoqëror ARSIS është një organizatë jofitimprurëse e themeluar në Tiranë në vitin 2016, ku prej vitesh kontribuon me ndërhyrje gjithpërfshirëse dhe zgjidhje të qëndrueshme nëpërmjet zbatimit të programeve të saj bazuar në garantimin e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve mbështetëse për kategoritë në nevojë dhe vulnerabël.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti Barleti:*
 - a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve për trajnime, ëorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
 - b. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - c. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Nisma ARSIS, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
 - d. Shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për përmbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet më të mira në nivel evropian;
 - e. Personi i kontaktit do të jetë: Znj. Reta Pinderi.
2. *Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS:*
 - a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;
 - b. Angazhohet në ofrimin e mundësive të punësimit për studentët më të mirë në përputhje me strategjitë e brendshme të zhvillimit të subjektit;
 - c. Angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, ëorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;



- d. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - e. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut Barleti, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm;
 - f. Personi i kontaktit do të jetë: Znj. Denita Mancellari
3. *Palët bashkërisht bien dakord si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
 - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese, të shprehur në një dokument të shkruar;
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, sjell si pasojë prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi;
3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipen në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti "Barleti"

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Rektor

Drejtoreshë Ekzekutive


Prof. Dr. Suzana Guxholli


Dr. Ana Majko

